

Edukimi shëndetësor ,shtator 2014

Reparti i mjekësisë sociale me edukimin shëndetësor,vazhdoi edhe në muajin shtator me promovimin e edukimit shëndetësor të popullatës në rajonin e Shkupit. Në muajin shtator 2014 ishin të mbajtura 212 ligjërata edukative ku ishin të përfshirë 3506 nxënës në arsim fillor dhe të mesëm dhe 611 fëmijë parashkollor.

Ligjëratat edukative ishin të realizuara në institucionin e fëmijëve për kujdesin e fëmijëve të vegjël „Sërniqka,, në komunën e Aerodromit, dhe në të gjitha klonet e kopshteve; Bambi,Izvorqe,Lale,Qekorqe,Kalinka, në temë higjiena personale dhe të ushqyerit e shëndoshë- të përfshirë 24 grupe.

Në muajin shtator, në ligjërata edukative ishin të përfshirë shkollat në vijim.

SH.M.Q.SH Gjorgji Dimitrov

SH.M.Q.SH Zef Lush Marku

SH.F Marko Cepenkov dhe njësit rajonale në fshatin Strakujadica dhe në fshatin Smesnica.

SH.F Naim Frashri

SH.F Mustafa Kemal Ataturk dhe njësit rajonale në fshatin Koliqani i epërm dhe në Koliqanin e poshtëm .

SH.F Emin Duraku dhe njësia rajonale në fshatin Qajlanë dhe në fshatin Arnaki në komunën e Karposhit,Aerodromit,Zelenikovës, Studeniqan dhe Butel.

Përmbajtjet edukative kanë përfshirë temat në vijim:

- Ushqimi i shëndetshëm shkollor dhe rreziku shëndetësor nga ushqimi jo i rregullt.
- Higjiena personale dhe parandalimi nga uji i pijshëm i pa sigurt.
- Sëmundje të varësisë
- Kontraceptivi
- Shtatzënia adoleshente dhe
- HIV/AIDS
- Infeksionet seksuale të transmetueshme

Gjithashtu ishin të mbajtura dy tribuna me temat në vijim:

- Sëmundjet e varësisë dhe
- Shtatzënia adoleshente

Dhe atë në shkollat fillore Marko Cepenkov në komunën e Zelenikovës dhe shkollën e mesme SHMQSH Zef Lush Marku, në komunën e Butelit.

Ishte e shënuar Dita Botërore e Zembrës në 29-shtatorë 2014, në bashkëpunim me SHMQSH Arseni Jovkov. Për atë qëllim janë organizuar gara rreth lumit Vardar morën pjesë 120 nxënës në vrapim dhe ecje të shpejt.

Në këshillimoren për dorëheqje nga duhani janë kryer 2 ligjërata individuale të klientëve si e para këshillim p[er dorëheqje nga duhani.

Në këshillimoren për shëndet seksual dhe riprodhues kanë dhënë këshilla për 50 nxënës, të cilëve ju është shpërndarë broshure, fletushka për infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe AIDS.



SH.F Mustafa Kemal Ataturk



SH.F Mustafa Kemal Ataturk



SH.F Naim Frashri



SH.F Marko Cepenkov



SHMQSH Arseni Jovkov



Përfaqësuesi i QSHP Shkup ne press të organizuar nga ISHP të RM-së me rastin e ditës botërore të zemrës